



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry

SHKËMBIMET TREGTARE

2014

Mars 2015

Përgatitur nga:

Merita Fetahu, Analiste e Tregtisë

Në këtë raport, burim i të dhënave për sektorin e jashtëm të Kosovës është Agjencia e Statistikave të Kosovës. Të dhënat e prezantuara në këtë raport përfshijnë totalin e eksporteve dhe importeve të Kosovës.

Të gjitha të dhënat e vitit 2014 janë preliminare.

Ministria e Tregtisë dhe
Industrisë

Muharrem Fejza.
p.n. Lagjja e Spitalit
10 000 Prishtina
Republika e Kosovës

Mars 2015

Përmbajtja

- Zhvillimet në tregtinë e jashtme të Kosovës
- Bilanci tregtar i mallrave
- Indeksi i varësisë tregtare
- Indeksi i tendencës së eksporteve
- Tregtia e jashtme e Kosovës, sipas destinimit
- Tregtia e Kosovës me vendet BE-së
- Tregtia e Kosovës me vendet CEFTA-s
- Tregtia e Kosovës me pjesën tjetër të botës
- Struktura e eksporteve
- Struktura e importeve

Figurat:

- Figura.1: Bilanci tregtar i mallrave
- Figura.2: Indeksi i varësisë tregtare
- Figura.3: Indeksi i tendencës së eksporteve
- Figura. 4: Bilanci tregtar me vendet e BE-së
- Figura 5: Bilanci tregtar me vendet e CEFTA-s
- Figura 6: Vendet me pjesëmarrje më të madhe në eksportet e përgjithshme ,%
- Figura 7: Vendet me pjesëmarrje më të madhe në importet e përgjithshme, %

Tabelat:

- Tabela. 1: Tregtia sipas grup-vendeve, %
- Tabela. 2: Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së
- Tabela. 3: Importet në Kosovë nga vendet e BE-së
- Tabela. 4: Eksportet e Kosovës në vendet e CEFTA-s
- Tabela. 5: Importet në Kosovë nga vendet e CEFTA-s
- Tabela. 6: Eksportet e Kosovës në pjesën e mbetur të botës – partnerët kryesorë

- Tabela. 7: Importet e Kosovës nga pjesën e mbetur e botës - partneret kryesorë
- Tabela 8: Partnerët kryesorë tregtarë të Kosovës – eksportet, importet, bilanci tregtar,
- Tabela. 9: Eksportet sipas grupit të produkteve bujqësore ushqimore
- Tabela. 10: Top 10 produktet e eksportuara në nivelin e eksporteve të përgjithshme
- Tabela. 11: Top 10 produktet importuara në nivelin e importeve të përgjithshme,
- Tabela. 12: Importet sipas seksioneve për vitet 2013 – 2014
- Tabela.13: Eksportet sipas seksioneve për vitet 2013 – 2014

Hyrje

Raporti “Shkëmbimet tregtare për vitin 2014” është një raport i përvitshëm, i cili pasqyron tendencat dhe analizën e indikatorëve kryesorë të treguesve të tregtisë së jashtme të Kosovës, si dhe potencialin e prodhuesve vendorë për eksport në nivelin rajonal dhe ndërkombëtar.

Andaj, trendët e tregtisë së jashtme japin një pasqyrë të qartë për shkallën e zhvillimit ekonomik dhe për këtë analiza e ecurisë dhe vëllimit të tregtisë së jashtme ka një rëndësi të veçantë.

Tabelat dhe figurat e paraqitura tregojnë trendët e zhvillimit të shkëmbimeve tregtare, strukturën e saj, vartësinë e furnizimit të tregut të brendshëm, cilësinë dhe gamën e mallrave etj.

Zhvillimet në tregtinë e jashtme të Kosovë

Pas një krize të gjatë, shoqëria kosovare ende ballafaqohet me një varg problemesh dhe vështirësish për t’iu bashkangjitur rrjedhave aktuale të zhvillimit ndërkombëtar, veçmas në sferën ekonomike. Kështu, çështjet që lidhen me tregtinë e jashtme të Kosovës, përkatësisht situata e përgjithshme tregtare jep një pasqyrë mbi gjendjen aktuale ekonomike, në një mënyrë shkallën e zhvillimit ekonomik, ku e shprehin edhe treguesit e tregtisë së jashtme, dhe për këtë analiza e ecurisë dhe vëllimit të tregtisë së jashtme nxjerr në pah gjendjen faktike të sektorëve prodhues vendorë.

Në sektorin e mallrave bilanci i tregtisë së jashtme është mjaft negativ i përcjellë nga viti në vit. Pengesat në zhvillimin e sektorit të jashtëm si: kolapsi i sektorit privat pas luftës, procesi i privatizimit, investimet e huaja direkte, performanca e kompanive të Kosovës, korniza ligjore etj., janë shkaqet që kanë ndikuar dhe ndikojnë në gjendjen e pavolitshme të sektorit të eksporteve.

Duke marrë për bazë se sektori i tregtisë së jashtme ka një rëndësi të veçantë në zhvillimin ekonomik, politika tregtare është një nga instrumentet kryesore të politikës së përgjithshme ekonomike.


Bilanci tregtar në mallra

Gjatë viti 2014, bilanci tregtar i Kosovës karakterizohet me deficit të lartë tregtar. Tregtia e jashtme e Kosovës arriti vlerën prej mbi 2.8 miliardë euro, tregues ky që është më i lartë se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak për 4 %.

Eksportet e mallrave arritën në 324 milionë euro, duke llogaritur një rritje prej 10% krahas vitit 2013.

Nga ana tjetër, importet e mallrave në vitin 2014, janë në vlerë prej 2.5 miliardë euro, duke llogaritur një ritëm më të ngadaltë të rritjes mesatare në vitet e fundit, njëkohësisht rritje për 3.6 për qind. Kontributi i eksporteve në volumin tregtar pothuajse është në nivel të njëjtë, edhe pse ka një rritje të lehtë në vitin 2014. Raporti i mbulimit të importeve nga eksportet, gjatë viteve të kaluara qëndroi në 12%('13) dhe 12.8% në 2014.

Konkretisht nga Fig. 1 mund të shihet se Kosova ka deficit të lartë tregtar në mallra, me një zgjerim të vazhdueshëm, i cili bëri që Kosova të ketë bilanc negativ (shih fig.1).

Figura.1: Bilanci tregtar i mallrave (ne '000 euro)

Eksportet e Kosovës kanë pasur një rritje të konsiderueshme nga viti '06, por me një rënie në vitin '09 dhe '12. Kështu, në vitin '09 eksportet pësuan një rënie (16.6 % krahasuar me vitin '08) për shkak të krizës ekonomike në '09. Megjithëse vendet në zhvillim të botës ishin më pak të prekura nga kriza financiare globale sesa vendet e zhvilluara, mirëpo shumë vende, duke përfshirë edhe Kosovën, ishte e pamundur të jenë imunë ndaj kësaj krize, andaj u përballën me një rënie të kërkesës për plasimin e produkteve në tregun e jashtëm.

Kështu, kriza globale ekonomike ka rezultuar me kërkesë më të ulët dhe çmime më të ulëta në tregjet ndërkombëtare, gjë që ndikoi edhe në tregtinë e jashtme të Kosovës. Çmimet të cilat pësuan rënie kryesisht janë: metalet, lëndët djegëse dhe ushqimet, kategori të cilat përbëjnë një pjesë të konsiderueshme në tregtinë e jashtme të Kosovës.


Indeksi i varshmërisë tregtare

Ky indeks mat raportin e tregtisë ndërkombëtare me vlerën totale të prodhimit (Bruto prodhimin vendor), ndryshe quhet edhe indeksi i çiltërsisë nga se jep një paskyrë për shkallën e hapur të tregtisë vendore me atë ndërkombëtare.

Nga tabela e mëposhtme Fig 2, shihet se si rritja e vazhdueshme e shkëmbimeve tregtare mes Kosovës dhe vendeve të tjera, përkatësisht rritja e importeve dhe eksporteve ka ndikuar në shkallën e hapjes tregtare që është në rritje në vitet e fundit (nga 40.4 për qind sa ka qenë në vitin 2005 në 57.2 për qind 2010, 58.9 për qind 2011 dhe 56.6 për qind 2012). Megjithatë, mbulimi i importeve me eksporte vazhdon të qëndrojë në nivel relativisht të ulët (12.8 për qind në vitin 2014), që nuk është një nivel i ndryshuar shumë nga viti paraprak.

$$\frac{\sum_s X_{ds} + \sum_s M_{sd}}{GDP_d} \times 100$$

Figura.2: Indeksi i varshmërisë tregtare, 2005 – 2012, %



Indeksi i tendencës së eksporteve

Tregon shkallën e përgjithshme të mbështetjes së prodhuesve vendës në tregjet e huaja, që mat peshën e eksporteve në Bruto Prodhimin Vendor (BPV). Kjo është e ngjashme me indeksin e varësisë tregtare, por mund të jetë një tregues i mirë i ndjeshmërisë ndaj llojeve të caktuara të goditjeve nga jashtë (p.sh., ndryshimi në çmimet e eksportit për shkak të ndryshimit të çmimeve në tregun ndërkombëtar ose ndryshimet në kurset e këmbimit).

Raporti i eksporteve ndaj BPV, përcaktohet si:

$$\frac{\sum_s X_{ds}}{GDP_d} \times 100$$

Figura.3: Indeksi i tendencës së eksporteve



Tregtia e jashtme e Kosovës sipas destinacionit

Kosova importon në mbi 130 vende të botës, ndërkaq produktet e prodhuara në Kosovë, kanë arritur në tregjet e mbi 60 vendeve të botës.

Tregtia me vendet e BE-s dhe vendeve të rajonit pjesëmarrëse në CEFTA, përbën pjesën më të rëndësishme të shkëmbimeve tregtare të Kosovës, me rreth 71% të gjithë tregtisë së jashtme.

Tabela. 1: Tregtia sipas grup vendeve, %

Grup vendet	EXS/ IMP	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
BE	Eksporti	41.7	29.3	38.8	38.2	42.6	47.8	43.1	44.5	43.0	38.4	39.4	30.2
	Importi	28.4	39.9	38.0	34.8	35.2	36.2	39.0	38.3	38.0	38.7	41.3	42.6
CEFTA	Eksporti	51.3	41.6	53.0	46.7	41.3	30.9	32.3	23.5	26.0	36.8	36.4	39.2
	Importi	45.6	34.7	38.0	41.1	36.7	37.5	35.7	37.0	35.0	33.7	30.6	28.4
Te tjerë	Eksporti	7.0	29.1	8.2	15.1	16.1	21.3	25.2	32.0	31.0	24.8	24.1	30.6
	Importi	26.0	25.4	24.0	24.1	28.1	26.2	25.0	24.5	27.0	27.6	28.1	29.0


Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, kalkuluar MTI

Të dhënat statistikore tregojnë që Kosova kryesisht tregon me dy grupe të vendeve, përkatësisht vendet e Bashkimit Evropian dhe vendet e CEFTA-s.

Tregtia me vendet e BE-së

Kosova, në aspektin e tregtisë së jashtme si partnere me të rëndësishme tregtare gjatë viteve të fundit i ka vendet e BE-së si në importe ashtu edhe në eksporte apo më mirë të themi në qarkullimin e tregtisë së jashtme. Nga kjo, 46% e shkëmbimeve tregtare të Kosovës gjatë vitit '14 ka qene e realizuar me vendet e BE-së. Më se 30% e eksporteve të përgjithshme të vendit janë destinuar në BE. Po ashtu importet nga vendet e BE-së mbulojnë pjesën më të madhe të importeve të përgjithshme në Kosovë me pjesëmarrje prej 42% (2014).

Figura. 4: Bilanci tregtar me vendet e BE-së



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Rritja e eksporteve ka qenë e shpejtë, kështu në vitet '07 dhe '08 rritja eksportit ishte jashtëzakonisht e madhe krahasuar me vitet e mëparshme nga 42.3 mil/€ sa ka qenë në vitin '06 në 69.3 mil/€ '07 përkatësisht 93.9 mil/ në vitin '08. Megjithatë, ndikimi i krizës financiare shkaktoi rënie të papritur, ndërkaq eksportet në BE nuk vazhduan në '09. Sa u përket importeve, nga viti në vit rritja ka qenë në mënyrë të qëndrueshme. Pavarësisht disa indikacioneve pozitive lidhur me performancën e eksportit, bilanci negativ tregtar i Kosovës me BE-në është zgjeruar vazhdimisht, duke arritur mbi 900 milionë euro (shih figurën 4).

Kështu gjatë vitit 2014, importi i mallrave nga vendet e BE-së ishte rreth 1 miliard euro ose 42.5% të importeve në nivel të importeve totale. Mallrat kosovare të eksportuara me destinim vendet e BE-së arritën në 98 milionë euro, ose 30.2% eksporteve të përgjithshme, rënie prej 17% (pa i përfshirë eksportet në Kroaci në vitin'13).

Tabela 2: Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së (ne '000 euro)

Year	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
PartnerC										
AUSTRIA	1,017	1,211	2,005	2,072	1,978	5,670	5,711	4,425	6,327	6,416
BELGIUM	19	17	5,587	28,113	5,176	11,455	5,085	473	807	716
BULGARIA	970	13,506	10,005	2,632	2,709	6,765	936	1,829	1,026	3,820
CYPRUS	0	0	0	2,623	117	27	224	0	5,971	1,748
CZECH REPUBLIC	0	356	159	1,127	463	297	168	422	492	2,524
GERMANY	5,965	3,952	16,190	7,205	7,563	15,587	24,144	14,995	10,985	11,339
DENMARK	142	44	94	53	75	44	52	161	74	320
ESTONIA	0	0	0	14	0	0	0	0	0	120
SPAIN	0	49	114	196	51	49	57	631	342	824
FINLAND	122	55	167	99	1	10	29	54	11	3
FRANCE	515	232	145	247	639	1,084	1,305	1,852	1,455	1,194
UNITED KINGDOM	72	62	154	173	249	681	1,343	2,194	2,131	1,314
GREECE	5,522	3,914	8,400	10,851	240	222	194	331	791	930
HUNGARY	92	18	112	105	396	29	89	118	233	118
IRELAND	3	20	48	10	3	6	7	0	5	36
ITALY	5,668	12,654	9,672	25,485	46,218	80,193	83,924	71,351	74,363	49,660
LITHUANIA	2	4	0	0	1	0	4	0	0	2,547

LUXEMBOURG	0	0	0	0	0	0	8	0	35	102
LATVIA	2	8	2	4	10	5	17	5	0	0
MALTA	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
NETHERLANDS	124	1,128	2,413	1,888	1,506	1,017	2,923	1,424	2,382	2,147
POLAND	102	281	121	102	53	150	650	737	3,870	5,782
PORTUGAL	0	2	0	0	0	8	20	301	0	10
ROMANIA	190	224	1,142	42	232	272	987	1,265	442	685
SWEDEN	18	43	8,155	4,389	322	1,116	365	264	615	992
SLOVENIA	1,231	4,515	4,290	6,304	2,882	6,203	6,001	1,417	1,434	620
SLOVAKIA	34	36	395	241	391	920	2,405	3,175	2,037	1,766
CROATIA										2,366
<u>TOTAL EU</u>	<u>21,811</u>	<u>42,332</u>	<u>69,370</u>	<u>93,974</u>	<u>71,274</u>	<u>131,811</u>	<u>136,646</u>	<u>107,423</u>	<u>115,828</u>	<u>98,096</u>

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Nga tabela e mësipërme shihet se Italia dhe Gjermania janë destinacionet kryesore për eksportet e Kosovës.

Tabela. 3: Importet në Kosovë nga vendet e BE-së (në ‘000 euro)

Year	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
PartnerC										
AUSTRIA	20,719	23,539	26,842	30,953	38,915	33,126	38,669	34,073	36,858	36,743
BELGIUM	4,646	4,733	6,012	7,223	6,106	6,394	8,656	8,869	9,290	6,677
BULGARIA	37,791	58,498	42,008	53,824	44,500	35,211	50,541	39,125	44,515	47,242
CYPRUS	757	680	570	1,269	1,164	841	948	2,279	603	978
CZECH REPUBLIC	8,710	11,491	11,390	15,365	17,054	20,707	19,323	19,134	16,574	17,902
GERMANY	123,763	122,652	155,031	196,627	246,170	280,617	293,441	304,195	252,594	273,029
DENMARK	1,730	1,806	3,751	6,194	3,418	2,624	3,545	3,016	3,068	3,029
ESTONIA	24	89	92	133	65	22	10	266	163	255
SPAIN	11,741	9,391	9,604	9,351	11,780	15,504	17,914	18,438	21,267	21,837
FINLAND	396	386	923	435	1,346	655	1,401	2,369	980	1,188

FRANCE	19,468	15,834	25,007	37,505	27,167	33,635	34,755	24,077	26,846	29,208
UNITED KINGDOM	7,478	6,378	9,502	12,580	14,153	13,457	17,084	13,630	13,209	13,580
GREECE	44,027	37,614	63,737	81,403	79,108	96,267	103,179	109,188	145,546	137,551
HUNGARY	16,233	20,011	25,537	37,694	27,046	28,950	35,020	27,665	28,236	24,878
IRELAND	1,424	1,661	2,231	2,157	3,254	3,097	2,010	1,979	2,103	2,003
ITALY	49,555	52,461	57,678	74,385	87,972	100,603	159,444	213,469	228,519	202,866
LITHUANIA	257	333	184	185	313	480	742	756	1,357	2,100
LUXEMBOURG	308	127	94	91	202	114	51	89	134	118
LATVIA	169	56	34	133	200	218	189	240	244	217
MALTA	44	7	0	4	23	33	1,393	570	124	74
NETHERLANDS	7,814	6,986	9,711	20,112	30,927	14,876	18,195	21,261	38,831	27,245
POLAND	14,836	13,796	14,067	22,223	24,215	39,876	32,963	30,970	36,595	55,820
PORTUGAL	151	514	173	337	422	1,407	809	788	919	1,244
ROMANIA	7,132	4,443	30,261	6,788	9,494	17,347	19,936	18,717	24,692	27,982
SWEDEN	2,455	2,353	12,387	11,089	9,252	8,286	9,049	8,444	7,734	9,652
SLOVENIA	54,998	56,001	62,420	66,762	66,378	65,738	71,614	68,385	61,314	66,708
SLOVAKIA	2,484	2,434	3,658	7,159	5,185	5,693	5,676	6,149	7,513	7,839
CROATIA										62,945
<u>TOTAL EU - 27</u>	<u>439,108</u>	<u>454,276</u>	<u>572,903</u>	<u>701,981</u>	<u>755,828</u>	<u>825,777</u>	<u>946,556</u>	<u>978,139</u>	<u>1,009,832</u>	<u>1,080,906</u>

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Tabela.3 tregon importet e Kosovës nga BE, situata nuk ndryshon shume. Në këtë aspekt, partnerët kryesorë tregtarë të Kosovës në importe nga vitet '05 deri '14 akoma janë Italia dhe Gjermania. Megjithatë, nga të dhënat statistikore të paraqitura në tabelë shihet se vendet tjera, nga të cilat Kosova importon janë Greqia dhe Sllovenia. Është gjithashtu domethënëse të përmendet që nga kjo tabelë në mësojmë që përfundimisht Kosova importon në një masë të caktuar nga të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian përveç vendeve të cekura (me theks të veçantë në Bullgari, Austri dhe Francë, në krahasim me të tjerët.)

Në përfundim, është e dukshme që partnerët tregtarë kyç të Kosovës nga grupi i vendeve të BE-së si në eksporte ashtu edhe në importe janë Italia dhe Gjermania.

Tregtia me vendet e CEFTA-së

Tabela 4: Eksportet e Kosovës në vendet e CEFTA-s (në '000 euro)

Year	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Partner										
ALBANIA	5,785	12,645	20,799	21,113	26,182	30,841	34,566	40,180	43,774	44,016
BOSNIA AND HERZEGOVINA	3,411	5,126	5,287	5,919	1,206	1,847	612	1,974	2,812	3,807
MOLDOVA,	0	0	0	1	9	12	10	11	4	7
MONTENEGRO	743	2,207	2,913	3,770	3,084	3,920	6,988	16,759	17,310	16,070
MACEDONIA	10,828	9,734	17,385	20,046	17,355	26,308	30,949	26,376	26,139	35,948
SERBIA	8,158	20,910	19,280	9,893	3,504	3,941	7,198	14,968	14,463	27,296
CROATIA	928	1,123	1,837	793	2,151	2,744	2,794	2,359	2,594	
TOTAL CEFTA	29,853	51,745	67,500	61,536	53,491	69,612	83,117	102,627	107,097	127,143

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Në tabelën e mësipërme, shifrat tregojnë eksportet e Kosovës drejt vendeve të CEFTA-s për vitet 2005-2014, kuptojmë se partnerët më atraktivë në vendet e CEFTA-s janë Shqipëria dhe Maqedonia. Nga ana tjetër, Serbia më 2006 dhe 2007, ka qenë një nga partnerët kryesorë sa i përket eksportit, megjithatë viti 2008, tregon një rënie të madhe të eksporteve drejt Serbisë. Ky ndryshim është kryesisht për shkak të arsyeve politike, duke pasur parasysh që më 2008, Kosova shpalli pavarësinë e saj, dhe për këtë arsye marrëdhëniet politike si dhe ekonomike midis këtyre dy vendeve u përkeqësuan edhe më tej.

Eksportet e Kosovës në vendet pjesëmarrëse në CEFTA kanë arritur në vlerë prej 127 milionë euro, rritje për 21.7%, ose 39.1 % të krejt eksporteve të Kosovës.

Ndërkohë, që mallrat e importuara nga vendet e CEFTA-s gjatë vitit 2014, arritën në 720 milionë euro, duke përfshirë 28.4% në nivel të importeve të përgjithshme.


Tabela 5: Importet në Kosovë nga vendet e CEFTA-së (në '000 euro)

Year	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Partner										
ALBANIA	18,093	23,108	35,262	59,632	58,385	69,714	96,400	110,528	110,597	133,700
BOSNIA AND HERZEGOVINA	18,450	18,465	29,838	38,747	59,742	82,986	79,835	85,309	83,531	64,793
MOLDOVA	19	77	30	118	24	50	559	183	430	138
MONTENEGRO	6,411	17,800	15,063	13,789	13,059	11,454	12,232	10,510	11,387	13,848
MACEDONIA,	220,148	257,754	237,895	346,536	292,012	319,313	365,961	287,739	185,020	139,612
SERBIA	152,257	191,053	222,534	208,951	211,133	260,471	254,917	278,388	285,356	368,237
CROATIA	24,975	28,074	38,982	49,985	58,584	58,542	64,063	72,012	73,331	
TOTAL CEFTA	440,352	536,331	579,604	717,759	692,939	802,530	873,967	844,669	749,651	720,328

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Duke parë importet e Kosovës me vendet e CEFTA-s, kuptojmë se partnerët kryesorë tregtarë janë Serbia (duke llogaritur 51% të importeve të Kosovës nga vendet e CEFTA-s vetëm për '14) dhe Maqedonia (me 19.4% të importeve të Kosovës nga vendet e CEFTA-s '14) e ndjekur nga Shqipëria, Bosnjë dhe Hercegovina. Mal i Zi është destinacioni më pak i favorshëm për importet kosovare.

Prandaj, nga këto dy tabela ne mund të konsiderojmë se partnerët më të rëndësishëm tregtarë të Kosovës (duke iu referuar vendeve që i përkasin marrëveshjes së CEFTA-s) si në aspektin e eksporteve dhe importeve janë Maqedonia, Shqipëria dhe Serbia.

Figura 5: Bilanci tregtar me vendet e CEFTA-s

Tregtia e Kosovës me pjesën tjetër të botës**Tabela.6: Eksportet e Kosovës në pjesën e mbetur të botës – partnerët kryesorë (në '000 euro)**

Viti/ Vendi	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Turqia	1,041	1,668	2,660	3,044	6,512	9,357	7,831	11,380	7,393	10,365
Zvicra	681	7,047	12,937	7,380	10,510	17,786	17,611	15,132	7,155	10,038
Kina	0	0	0	31	1,595	14,779	28,268	3,266	1,290	42,152
India	0	0	3,141	24,089	15,528	44,895	15,482	22,889	28,953	27,425

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Tabela e mësipërme tregon eksportet e Kosovës drejt vendeve nga pjesa tjetër e mbetur e botës. Si rezultat i shifrave të paraqitura në tabelë në termin e eksportit, partnerët kyç tregtarë të Kosovës deri në vitin 2014 janë Kina, India dhe Turqia. Është e rëndësishme të përmendet që përderisa Turqia dhe Zvicra kanë qenë partnerët tregtarë të Kosovës nga 2006 e tutje, nuk ishte i njëjti rast me Indinë dhe Kinën. Vetëm pas 2008, këto vende u bënë destinacione të rëndësishme për eksportet e Kosovës. Pas 2008, India ishte partneri me domethënës tregtar i Kosovës me një rritje të konsiderueshme.

Kina u bë partneri më i rëndësishëm tregtar nga të katërt e listuar në tabelë (në 2011 Kosova ka eksportuar në Kinë një shumë prej 28.2 milionë euro), gjendja ndryshoi në 2012, vlera mallrave të eksportuar ishte për 3.2 milionë euro, përkatësisht në 1.2 mil/€ në 2013, por me një rritje ekstreme 42.1mil/ euro në 2014.


Tabela. 7: Importet e Kosovës nga pjesën e mbetur e botës - partnerët kryesorë (në'000 euro)

Viti/ Vendi	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Turqia	85,375	97,075	101,827	128,249	141,545	150,360	184,452	199,881	204,922	238,267
Zvicra	18,415	22,800	28,222	32,441	21,949	20,981	22,194	22,664	21,020	30,184
Kina	54,864	74,655	104,951	121,059	128,318	135,406	170,285	159,904	179,589	204,934
SHBA	17,693	11,555	14,698	23,610	26,703	35,311	42,847	46,916	52,152	62,713
Brazili	16,840	18,578	30,282	43,499	37,888	27,188	40,925	41,791	45,756	39,546

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës


Nga ana tjetër, në (tabelën 7) janë shfaqur partnerët kryesorë për importet në Kosovë, nga pjesa e mbetur e botë. Në këtë drejtim, nga 2005 deri në 2014, dy partnerët me të rëndësishëm të Kosovës në importe janë Turqia dhe Kina. Turqia në këtë aspekt kryeson tabelën (Kosova ka importuar nga Turqia më 2014, një shumë prej 238 milionë eurosh), ndjekur nga Kina. Partnerë të tjerë tregtarë të rëndësishëm, duke u bazuar në importe siç shihet në tabelë janë: Shtetet e Bashkuara, Brazili dhe Zvicra.

Figura. 6: Vendet me pjesëmarrje më të mëdha në eksportet e përgjithshme, % (2014)



Shënim: 84.6% të eksporteve të përgjithshme të mallrave të Kosovës janë të destinuara në vendet e paraqitura në figurën 6.

Vendi më atraktiv për eksportet e Kosovës mbetet Italia 15.3% pjesëmarrje në eksportet e përgjithshme, e ndjekur nga Shqipëria 13.6%, pasuar nga Kina 13%, Maqedonia 11 % etj. Vlen të ceket se në tre vjetët e fundit Mali i Zi ka hyrë në top 10 vendet me eksportin më lartë të mallrave kosovare.

Figura. 7: Vendet me pjesëmarrje më të madhe ne importet e përgjithshme, % (2014)

Shënim: 72% të mallrave importues vijnë nga vendet e paraqitura në Fig. 7

Nga figura 7, kuptojmë se partneri kryesor në importe për vitin 2014, është Serbia me (14.5% pjesëmarrje në importet totale të Kosovës), pasuar nga Gjermania (10.8%). Partnerë të tjerë tregtarë të rëndësishëm në importe janë, Turqia, Kina, Italia, Maqedonia etj., (shih Figurën 7).

Tabela. 8: Partneret kryesor tregtare të Kosovës – eksportet, importet, bilanci tregtar / 2014

Partnerët tregtar	Eksportet		Importet		Bilanci tregtar	
	Vlera('000 Euro)	pjesëmarrja (%)	Vlera('000 Euro)	pjesëmarrja (%)	Vlera('000 Euro)	pjesëmarrja (%)
BE	98,096	30.2	1,080,906	42.5	-982,810	44.4
CEFTA	127,143	39.1	720,328	28.4	-593,185	26.8
EFTA	10,081	3.1	32,446	1.3	-22,365	1.0
KINA	42,152	13	204,934	8.1	-162,782	7.4
INDIA	27,425	8.5	9,445	0.4	17,980	-0.8
US	500	0.2	62,713	2.5	-62,213	2.8
BRAZIL	0	0	39,546	1.6	-39,546	1.8
Pjesa mbetur	19,157	5.9	387,914	15.3	-368,757	16.7
Total	324,554	100	2,538,232	100	-2,213,678	100.0

Struktura e tregtisë së jashtme

Struktura e eksporteve

Analizat statistikore për tregtinë e jashtme referuar sipas grup-mallrave apo sipas sistemit të harmonizuar, na japin një pasqyrë të qartë për strukturën eksporteve e cila ka qenë:

Grupi i produkteve ushqimore - Gjatë vitit 2014, në raport me vitin paraprak, eksportet që hyjnë në grupin e produkteve bujqësore - blegtorale dhe ato të industrisë ushqimore janë rritur për 12.7% dhe kanë zënë 12 % të vlerës së përgjithshme të eksporteve. Vlera e mallrave të eksportuara për këtë grup produktesh është 39.3 mil/ €.

Tabela. 9: Eksportet sipas grupit të produkteve bujqësore ushqimore, në 000€

Seksionet sipas sistemit të harmonizuar (HS)	2013	2014	Diferenca	↓↑%, 2014/13
Kafshë të gjalla, produkte me origjinë kafshe	156	309	153	98.4
Produkte bimore	15,408	18,550	3,141	20.4
Yndyrë	46	19	-26	-57.6
Ushqime të përgjithshme pije dhe duhan	19,337	20,494	1,157	6.0

Nga tabela e mësipërme shihet se produktet bimore dhe ushqimet e përgatitura, pijet janë kategoria kryesore e produkteve ushqimore të eksportuara, ndërkaq vlera e tyre ka tendencë rritjeje dhe kjo rritje premtan një trend pozitiv.

Kështu, nga krahasimi i treguesve real të tregtisë, rezulton se në sektorin e industrisë së ushqimit dhe pijeve në këtë vit kemi një rritje prej 6% të vlerës së eksporteve, krahasuar me vitin '13 si dhe të produkteve bimore për 20.4%.

Grupi i produkteve industriale - jo ushqimore

Eksporti i produkteve industriale jo-ushqimore për vitin 2014, rezulton me rritje prej 10%, vlera e mallrave industriale të eksportuara me përbërje jo-ushqimore gjatë kësaj periudhe është 285 milionë euro. Eksportet kosovare me këto kategori mallrash vazhdojnë të kenë peshën më të lartë të eksporteve, duke përfshirë 88 për qind të eksporteve të përgjithshme.

Edhe gjatë këtij viti eksportet e metaleve bazë të papërpunuara dhe produktet minerale kanë mbuluar 65 % të eksporteve në nivelin e përgjithshëm.

Megjithatë, metali bazë prapë mbetet zëri kryesor në eksportet e Kosovës. Gjithashtu, ndonëse me ndikim më të vogël në eksportet e përgjithshme, perspektiva e rritjes së prodhimit në sektorin e tekstilit dhe artikujve për mbathje është optimiste, për më shumë shih Tabelën 13.

Tabela.10: Top 10 produktet eksportuara në nivelin eksporteve të përgjithshme (HS-6)

Kodi i mallrave	Emërtimi produktit	2013	2014	Diferenca	↑↓%
720260	Ferro – nikel	88,402,350	107,310,570	18,908,220	21.4
720449	Kthime dhe mbetje ferrike; lingota mbetjesh të rishkrirëshme prej gize dhe çeliku	20,084,114	21,735,519	1,651,405	8.2
271600	Energji elektrike	21,820,972	16,028,771	-5,792,201	-26.5
260700	Xehe dhe koncentre plumbi	15,195,630	14,003,805	-1,191,824	-7.8
260800	Xehe dhe koncentre zinku	5,069,753	8,588,826	3,519,073	69.4
740400	Mbetjet dhe kthimet e bakrit:	10,049,319	8,568,042	-1,481,278	-14.7
551110	Prej fibrave kryesore sintetike, që përmbajnë ndaj peshës 85 % apo më shumë fibra të tilla	7,580,888	8,168,713	587,826	7.8
760200	Mbetje dhe kthime alumini:	5,743,752	6,527,196	783,443	13.6
110100	Miell gruri dhe miell meslini:	8,420,856	6,499,682	-1,921,175	-22.8
730690	Tuba, tubacione dhe profile të tjera (p.sh., me tegele saldimi të hapura apo të salduara, perçinuar apo të mbyllura në mënyra të ngjashme), prej gize dhe çeliku:	3,552,532	5,797,400	2,244,869	63.2

Struktura e importeve

Grupi i produkteve ushqimore - Mallrat e importuara të përfshirë në këtë grup produktesh është 24.3% ndaj totalit të importeve në Kosovë, duke arritur vlerën prej 616 milionë euro, rritje për 5.5%.

Produktet më të importuara në kategorinë e produkteve bujqësore ushqimore janë: cigaret, ujërat, përfshirë ujërat minerale dhe ujërat e gazuar, mishi dhe të brendshmet e ngrënshme, biskota, sheqer etj.

Grupi i produkteve industriale - jo-ushqimore - është në vlerë prej 1.922.1 mil/€ pjesëmarrje 75.7% në importet e përgjithshme, e cila ka shënuar rritje për 3% ndaj vitit të kaluar.

Por, si produkte të veçanta më të importuara në Kosovë janë: vajrat e naftës, auto-vetura dhe mjete të tjera transporti, shufra dhe shkopinj prej hekuri (ose shufrat e çelikut), medikamente, çimento etj.

Tabela. 11: Top 10 produktet importuara në nivelin e importeve të përgjithshme (HS – 6)

Kodi i mallrave	Emërtimi i produktit	2013	2014	Diferenca	↑↓%
271019	Vajra të mesme:	270,116,577	255,890,258	-14,226,319	-5.3
240220	Cigare që përmbajnë duhan:	60,070,906	57,996,491	-2,074,415	-3.5
870332	Auto-veturë të një cilindri me kapacitet që e kalon 1500 cm ³ por nuk e kalon 2500 cm ³ :	52,282,037	55,975,317	3,693,280	7.1
721420	Shufra çeliku jo të lidhur, të farkëtuara, që përmbajnë dhëmbëzime, brazda, flaxha apo deformime të tjera të prodhuara gjatë procesit të petëzimit apo të përdredhura pas petëzimit	73,549,563	53,994,659	-19,554,904	-26.6
271600	Energji elektrike	28,447,948	45,823,382	17,375,433	61.1
271012	Vajra të lehtë dhe përgatitjet:	51,547,538	45,362,471	-6,185,067	-12.0
300490	Medikamente, të dozuar për shitje me pakice, të tjera	30,313,958	35,184,811	4,870,853	16.1
220210	Ujërat, përfshirë ujërat minerale dhe ujërat e gazuar, që përmbajnë sheqer apo lëndë të tjera ëmbëltuese apo aromatizuese shtesë	30,744,817	34,518,425	3,773,608	12.3
252329	Çimento portland:	38,968,762	34,271,143	-4,697,618	-12.1
020714	Prerje dhe të brendshme, të ngrira	33,462,557	33,635,467	172,910	0.5

Tabela. 12: Importet sipas seksioneve për vitet 2013 – 2014 (në vlere. 000€)

Seksionet sipas sistemit të Harmonizuar (HS)	2013	2014	Diferenca	↓↑%, 2014/13
Gjithsej	2,449,064	2,538,232	89,168	3.6
Kafshë të gjalla, produkte me origjinë kafshe	105,769	115,340	9,571	9.0
Produkte bimore	124,349	133,060	8,710	7.0
Yndyrë	25,670	24,912	-758	-3.0
Ushqime të përgjithshme, pije dhe duhan	327,916	342,739	14,823	4.5
Produkte minerale	481,288	467,781	-13,507	-2.8
Produkte të industrisë kimike	190,264	195,607	5,344	2.8
Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre	148,148	147,861	-287	-0.2
Lëkurë dhe artikuj prej tyre	4,899	7,249	2,350	48.0
Druri dhe artikuj druri	52,809	55,112	2,302	4.4
Letër dhe artikuj prej letre	38,752	38,786	34	0.1
Tekstil dhe artikuj tekstili	87,616	120,236	32,620	37.2
Veshmbathje të këmbëve	23,956	28,952	4,996	20.9
Art.prej guri, allçie, prodh. qeramike dhe qelqi	96,772	100,279	3,508	3.6
Perla, gurë të çmuar, metale të çmuara etj.	1,956	1,813	-143	-7.3
Metale bazë dhe artikuj prej tyre	247,173	227,929	-19,244	-7.8
Makineri, pajisje mekanike dhe elektrike	256,816	286,347	29,531	11.5
Mjetet e transportit	135,482	140,876	5,394	4.0
Instr.optike,mjekësore,fotog.,muzikore etj.	25,999	29,372	3,373	13.0
Armët dhe municionet	1,158	521	-637	-55.0
Artikuj të ndryshëm të prodhuar	70,312	70,465	153	0.2
Veprat e artit	1,959	2,993	1,034	52.8

Tabela.13: Eksportet sipas seksioneve për vitet 2013 – 2014 (në vlere. 000€)

Seksionet sipas sistemit të Harmonizuar (HS)	2013	2014	Diferenca	↓↑%, 2014/13
Gjithsej	293,842	324,554	30,711	10.5
Kafshë të gjalla, produkte me origjinë kafshe	156	309	153	98.4
Produkte bimore	15,408	18,550	3,141	20.4
Yndyra	46	19	-26	-57.6
Ushqime të përgj. pije dhe duhan	19,337	20,494	1,157	6.0
Produkte minerale	48,352	44,704	-3,647	-7.5
Produkte të industrisë kimike	1,739	2,608	869	50.0
Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre	18,205	16,274	-1,931	-10.6
Lëkurë dhe artikuj prej tyre	11,691	11,365	-326	-2.8
Druri dhe artikuj druri	2,134	2,720	586	27.4
Letër dhe artikuj prej letre	1,751	2,494	742	42.4
Tekstil dhe artikuj tekstili	12,751	14,690	1,940	15.2
Veshmbathje të këmbëve	651	1,777	1,127	173.2
Art.prej guri, allçie, prodhime qeramike dhe qelqi	1,195	2,927	1,732	145.0
Perla, gurë të çmuar, metale të çmuara etj.	113	10	-103	-91.3
Metale bazë dhe artikuj prej tyre	143,911	167,376	23,465	16.3
Makineri, pajisje mekanike dhe elektrike	12,590	13,380	791	6.3
Mjetet e transportit	512	941	429	83.7
Instr.optike,mjekësore,foto, muzikore etj.	562	299	-263	-46.8
Armët dhe municionet	0	0	0	#DIV/0!
Artikuj të ndryshëm të prodhuar	2,613	3,559	946	36.2
Veprat e artit	127	58	-69	-54.3